
MBI DISA IDIOMA TË PËRBASHKËTA NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE ON SOME COMMON IDIOMS IN ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE

ANDI KOSTA

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, SHQIPËRI
E-mail: andikosta@m.com

AKTET VI, 4: 356 - 359, 2012

PËRMBLEDHJE

Duke qenë se mes gjuhëve të ndryshme ekziston dhënie-marrja reciproke ose ura lidhëse të tilla si idioma, të cilat përmbajnë kuptime të përbashkëta, njohja e këtyre urave lidhëse mundëson të nxënit sa më të mirë dhe më të shpejtë të një gjuhe të caktuar. Njëkohësisht, duke marrë në konsideratë faktin që idiomat shprehin një pjesë të kulturës së një kombi, shkrimi i mëposhtëm synon të përqsasë grupe të caktuara idiomash, të cilat ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu nuk do të shmanget edhe shqyrtimi i idiomave të cilat mund të kenë ndryshime kuptimi në njërin nga gjuhët. Shkrimi i mëposhtëm përveç përqsasjeve të mësipërme synon të evidentojë burimet e idiomave, kuptimet e tyre në gjuhët respektive, pikëtakimet kulturore që kanë mundësuar përdorimin e këtyre idiomave në të dyja gjuhët. Njohja e këtyre idiomave do të përqsasë dy kulturat edhe në një kontekst të ri, në kontekstin e globalizimit të gjuhës angleze në ditët e sotme.

Fjalët çelës: idiomë, kulturë, globalizim, histori, burime, kuptim.

SUMMARY

Provided that among different languages there exists the reciprocal giving and receiving or linking bridges such as idioms, which contain common meanings, knowledge of these linking bridges enables the best and fastest learning of a certain language. Meanwhile, considering the fact that idioms express a part of a nation's culture, the following article aims at comparing certain groups of idioms, which maintain the same meaning while used parallel both in English and Albanian. In meantime examination of idioms which can undergo changes in meaning in one of the languages will not be averted. Except for the comparisons, the following article aims at making the sources of the idioms, their meanings in the respective languages, the cultural contacts which have enabled the use of these idioms in both languages evident.

Key words: idiom, culture, globalization, history, sources, meaning.

Hyrje

Duke marrë në konsideratë faktin që idiomat shprehin një pjesë të kulturës së një kombi, shkrimi i mëposhtëm synon të përqsasë grupe të caktuara idiomash, të cilat ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu nuk do të shmanget edhe shqyrtimi i idiomave të cilat mund të kenë ndryshime kuptimi në njërin nga gjuhët. Shkrimi i mëposhtëm përveç përqsasjeve të mësipërme synon të evidentojë burimet e

idiomave, kuptimet e tyre në gjuhët respektive, pikëtakimet kulturore që kanë mundësuar përdorimin e këtyre idiomave në të dyja gjuhët. Njohja e këtyre idiomave do të përqsasë dy kulturat edhe në një kontekst të ri, në kontekstin e globalizimit të gjuhës angleze në ditët e sotme.

Grupe të caktuara idiomash, të cilat ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

(1) Të gjitha rrugët të çojnë në Romë:: All roads lead to Rome.

Kjo idiomë me bazë latine në kuptimin e plo-të të fjalës, ish një fakt në ditët e Perandorisë Ro-make, kur çdo rrugë të çonte ose dre-j-t-pë-r-drejt në Romë, ose lidhej me një prej rrugëve kry-esore që çonin drejtpërdrejt në Romë. Ky fakt ndihmoi të theksonte jo veç rëndësinë e qy-tetit kryesor për Perandorinë Romake, por gji-thashtu përmirësoi tregtinë duke e bërë më efe-ktive lëvizjen në rrugët tregtare si edhe lë-vi-zjen e trupave ushtarake.

Në shoqërinë moderne, mund të vërehet se shu-mica e qyteteve kryesore janë ndërtuar në një stil të ngjashëm me atë të Romës së la-sh-të. Bazuar në faktin e mësipërm, pra, që si-s-te-mi i shkëlqyer i ndërtimit të rrugëve fi-llo-n-te dhe përhapej prej kryeqytetit, kjo metaforë ka qenë përdorur në gjuhën angleze në vitin 1100.

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo idiomë ose shprehje frazeologjike në gju-hën angleze dhe shqipe, interpretohet me një shu-mësi metodash ose mënyrash, të cilat ja-pin të njëjtin rezultat ose me anë të cilave arri-het i njëjti qëllim. Siç shihet në të dyja gju-hët respektive, shqip dhe anglisht, kjo idi-o-më vjen e huazuar.

(2) Roma nuk u ndërtua në një ditë:: Rome as'n't built in one day.

Kjo idiomë përdorej si një fjalë e urtë fra-n-ce-ze në fund të vitit 1100, por nuk ish e re-gji-s-t-ruar në gjuhën angleze deri në vitin 1545.

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo idiomë ose shprehje frazeologjike në gju-hën angleze dhe shqipe, interpretohet si një urdhër, lutje, justifikim apo shfajësim për di-ke me qëllim që personi të tregohet i duruar pa-si një përgjegjësi apo sipërmarrje e rëndë-si-shme ka nevojë për kohë me qëllim që të rea-lizohet me sukses. Siç shihet edhe në këtë rast, në të dyja gjuhët respektive, shqip dhe an-glisht, kjo idiomë vjen e huazuar.

(3) Nyja Gordiane – Gordian Knot

Nyja Gordiane apo "Lidhja Gordiane" në mi-to-logjinë greke ishte një lidhje e ndërlikuar. Për këtë arsye askush nuk mund ta zgjidhte. Kjo sintagmë idiomatike lidhet gjithashtu me le-gjendën e Gordiasit nga Frigjia, shpallur mbret

në bazë të profecive bërë prej ora-ku-llit. Aleksandri i Madh, me sukses e zgjidhi Ny-jen Gordiane me anë të shpatës, ndërsa hy-ri në Gordium në vitin 333 p.k.. Prej kë-n-dej rrjedh edhe sintagma "Zgjidhja Alek-sa-n-driane".

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo sintagmë idiomatike përdoret shpesh si një metaforë për një problem vështirë të zgji-dhur lehtësisht me anë "të të menduarit ndry-she, të menduarit krijues". Shprehja "Nyja Gor-diane" përdoret edhe në ditët tona, më së shpe-shti nga politikanët në kuptimin: çështje e cila në vështrim të parë duket pa zgjidhje. Siç shihet edhe në këtë rast, në të dyja gjuhët re-s-pektive, shqip dhe anglisht, kjo idiomë vjen e huazuar.

(4) mollë sherri:: apple of discord.

Sintagma "mollë sherri" rrjedh prej një his-to-rie të njohur të mitologjisë greke, pikërisht hi-storia e mollës së artë, e cila shkaktoi di-s-ku-time të zjarra mes tri perëndeshave, pë-r-ka-tësisht Herës, Athinës dhe Afërditës lidhur me përcaktimin se kush ish më e bukura nga të trija. Në pamundësi për ta zgjidhur mes ty-re, ato kërkuan ndihmën e bariut Parid, i cili zgjo-dhi Afërditën. Afërdita i premtoi gruan më të bukur në botë, Helenën, e cila solli tra-gje-dinë e Trojës.

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo sintagmë idiomatike përdoret shpesh për një çështje që nxit debat, zili apo grindje. Siç shi-het edhe në këtë rast, në të dyja gjuhët re-s-pektive, shqip dhe anglisht, kjo idiomë vjen e huazuar.

(5) mori emër:: to make a name for oneself.

Përdorimi më i hershëm i sintagmës "mori emër" regjistrohët në përkthimin e Biblës prej ndjekësve të John Wycliffe (rreth viteve 1332-1430)". Më konkretisht, tek Libri i dytë i Profetit Samuel 8:13 thuhet: "Davidi i bëri emër vetes".

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo sintagmë idiomatike nënkupton të fitosh fa-më, të bëhesh i famshëm, një person me rë-n-dësi, person me influencë.

(6) Rron si peshku pa ujë:: (To be) Like a fish out of water.

Kjo idiomë është mjaft e vjetër në gjuhën an-g-leze. Chaucer përdori një version të saj në The Canterbury Tales: Prologue. Si re-fe-re-n-ca e

saj më e hershme njihet "Pelegrinazhi" nga Samuel Purchas në 1613.

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo idiomë përdoret shpesh për një situatë kur personi ndihet i parehatshëm, e thënë ndryshe "a person does not feel at home", "një person nuk rri si në shtëpinë e vet". Në shqip kjo idiomë përdoret rëndom për ko-n-te-k-ste të ndryshme, duke iu përmbajtur inter-p-re-timit të mësipërm.

(7) Ngul këmbë si mushka ose kokëfortë si mushka:: As obstinate as a mule.

Kjo idiomë daton në gjuhën angleze në fillim të vitit 1800.

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo idiomë në gjuhën angleze përdoret një-ko-hë-sisht edhe për qenien njerëzore dhe për kaf-shët. Në shqip kjo idiomë përdoret gje-rë-sisht në kontekste të ndryshme për të treguar ko-këfortësinë e dikujt, ngulmimin e një perso-ni me të madhe që të realizohet diçka me patjetër.

(8) Me një gur vras dy zogj:: To kill two birds with one stone.

Ekziston një thënie kineze "yi shi er niao", e cila fjalë për fjalë përkthehet "një gur, dy zogj". Ekziston gjithashtu një tjetër thënie ki-neze "yi jian shuang diao", e cila për-k-the-het "një shigjetë, dy huta", të dyja thënie me të njëjtin përdorim. Në mitologjinë greke gje-jmë historinë e Dedalus-it, i cili mbahet i bur-gosur prej mbretit Minos në një kullë të la-rtë në Kretë. Dedalusi harton një plan për të goditur me gur zogjtë e mëdhenj duke shpresuar të krijojë krahë artificialë, të cilët do ta ndihmojnë të arratiset. Ai zbulon që me një hedhje mjeshtërore të gurit ai mund të go-dasë një zog e më pas guri bën rikoshetë duke goditur një zog të dytë, pra "me një gur ai mund të vrasë dy zogj".

Për t'u ndalur pak më gjerësisht tek kuptimi, kjo idiomë nënkupton se me një veprim të ve-tëm zgjidhen dy probleme njëkohësisht. Siç shihet edhe në këtë rast, në të dyja gjuhët re-spektive, shqip dhe anglisht, kjo idiomë vjen e huazuar.

Përfundim

Bazuar në krahasimin e mësipërm mbi disa prej idiomave konsideruar ndër më të njo-hu-ra dhe më të përdorura në të dyja gjuhët respektive,

idioma, të cilat ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, si konkluzione pa-raprake, mund të nxjerrim pikat e për-ba-shkëta dhe përfitimet që ato sjellin.

Këto idiomat të përbashkëta në gjuhën Shqipe dhe Angleze:

1. Ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit pa-ralel në gjuhën shqipe dhe në gjuhën ang-le-ze duke lehtësuar kësisoj komunikimin e ndërsjellë.

2. Disa prej këtyre idiomave të përbashkëta ja-në të huazuara nga gjuhë të tjera (prej la-ti-ni-shtes, greqishtes, frëngjishtes).

3. Në gjuhën shqipe nuk jepet informacion li-dhur me datimin e këtyre idiomave.

4. Duke qenë pjesë e fjalorit aktiv të dy gju-hëve respektive, këto idiomat të përbashkëta nxi-sin interesin në mësim-nxënien efikase dhe të shpejtë të gjuhëve në shqyrtim.

5. Ato dëshmojnë pika lidhjeje mes kul-tu-ra-ve të të dy vendeve, duke ndërtuar kësisoj ura më të forta bashkëpunimi reciprok.

6. Në kontekstin e ri të globalizmit, kur gju-ha angleze konsiderohet si "lingua franca" e epo-kës në të cilën jetojmë, është me interes që të forcohen marrëdhëniet ndërgjuhësore dhe kulturele mes gjuhës shqipe dhe asaj angleze.

7. Sa u përket idiomave, të cilat nuk ruajnë të njëjtin kuptim gjatë përdorimit paralel në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, vlen të the-ksohet se ato janë po aq të rëndësishme dhe po aq të vlera, pasi ato përbëjnë një pjesë të qenësishme të gjuhës së folur. Studimi i ty-re përbën një sfidë ndoshta më të madhe, për vetë faktin se ato mund të konsiderohen "gjuhë e huaj e mirëfilltë".

Bibliografi

FRAZELOGJIZMA të Gjuhës Shqipe, Gjevori, Mehmet, "8 Nëntori", Tiranë (1979).

ENGLISH Idioms and How to Use Them, Seidl, Jennifer, McMordie, W. Oxford University Press (1978).

THE DICTIONARY of Cultural Lite-ra-cy Hirsch, Kett, Trefil (1988).

CAMBRIDGE Learner's Dictionary, second edition: dictionary.cambridge.org.

[HTTP://wiki.answers.com](http://wiki.answers.com)

THE POCKET Oxford Dictionary, Oxford University
Press 1994.

[HTTP://dictionary.com](http://dictionary.com)

ALEXANDER cuts the Gordian Knot by Jean-Simon
Berthélemy (1743-1811).